

ROVENA VATA

GJERGJ FISHTA, NJË VETËDIJE ESTETIKO-ATDHETARE, DY TABLO KONTRASTUESE NGA ATDHEU

Parashtrimi: At Gjergj Fishta ka lënë gjurmë të spikatura në letërsinë shqipe me veprën e tij letrare, por dhe më gjerë, në tërë botën shqiptare është dalluar me angazhimet e shquara në fusha të rëndësishme, jetike për mbarë shqiptarët.

Nëpërmjet strategjisë së veçantë të rrëfimit poetik në *Lahutën e Malcis* Fishta njësoi idealet, njësoi kohët dhe breznitë e ndryshme, nëpërmjet trajtimit të ngjarjeve, ndodhive e luftërave njësoi veprimet; futi e ndërlidhi me shkathhtësi qenie të shumta mitike, zakone e doke të lashta, rite e rituale të trashëguara e të ruajtura në shekuj, që përbënin mëvetësinë e pasurinë e botës shqiptare.

Vepra letrare e Fishtës u shkrua gjatë dyzet vjetëve, u shkrua në një periudhë dramatike për Shqipërinë e shqiptarët. Fishta provoi penën e tij në epikë, lirikë, dramatikë, satirikë dhe në tekste me karakter publicistik, diskursiv, politik, socio-psikologjik, veprat e tij epike është: *Lahuta e Malcis*.

Gjergj Fishta “*rishqyron*” traditën homerike, traditën gojore historike nacionale, si dhe traditën gojore mitologjike¹.

Fishta duke përdorur shenjat nacionale krijon fenomenologjinë e artit të vet; shpërfaq dhembjen për fenomenet si gjuha shqipe, atdheu, flamuri, të cilat si të tilla e “sulmojnë” pa ndalur egon e tij, ku lexuesi edhe po s’e pa emrin e autorit në fund apo në krye të poezive të tij fenomenologjike nacionale, pa dyshim se gjithmonë do ta bëjë pyetjen: a thua kush e shkroi kaq vrullshëm e me zemër kaq të l’nueme për vendin e vet².

¹ N. Krasniqi, *Autori në letërsi*, AIKD, Prishtinë, 2009, f. 78.

² Po aty, f. 100.

Fishta, prift i urdhërit françeskan, poet, studiues i letërsisë dhe i traditës popullore, njeri i letrave në përgjithësi, veprimtar politik i periudhës së rilindjes kombëtare dhe të pavarësisë, njohës i psikikës nacionale shqiptare dhe i së drejtës zakonore të vendit, figurë qendrore e mendimit shqiptar në katër dekadat e para të këtij shekulli, dijetar dhe letrar, estet dhe shkencëtar³, ai ishte një politikan që u tregoi shqiparëve se çka është Shqipëria e botës së qytetëruar kush janë shqiptarët⁴.

Fishta jetoi një pjesë të madhe të jetës së tij në malësi, ku tradita letrare gojore, sidomos epika e mirëfilltë gojore, ishte shumë e pasur. Qyteti i Shkodrës ishte një qendër e madhe kulturore dhe letrare. Tri janë cilësitë kryesore të krijimtarisë letrare gojore, që ky autor i pati për bazë dhe i përdori në veprat e veta: a) nevoja për bashkimin e kombit, b) dashuria ndaj atdheut dhe c) dashuria ndaj gjuhës, përkatësisht dëshmia për cilësinë dhe pasurinë e gjuhës shqipe edhe si gjuhë letrare artistike⁵.

Fishta filloi të këndonte Lahutën e Malcis për ta lartësuar fisin shqiptar përmes elementeve themelore që përbëjnë brumin etnografik dhe për të cilët shqiptarët janë dalluar gjithmonë nga popujt e tjerë ballkanikë dhe janë admiruar nga studiuesit evropianë; e këto janë: lidhja me fisin, mikpritja, nderi, burrnia, besa, solidariteti, liria, pavarësia, besimi në qenie mitike⁶.

Kryevepra e tij për shumicën e shqiptarëve është “Lahuta e Malcis”, e cila u shkrua në frymë tradicionale popullore dhe u konceptua si ringjallje e epopesë kombëtare shqiptare. Fishta e emancipoi letërsinë shqipe duke e gjetur lavdinë e historisë tre shekuj më këndej “motit të madh” të qëndresës së Skënderbeut, duke krijuar epopenë e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ai iu përgjigj pozitivisht pyetjes nëse kishte diçka të rëndësishme, heroike, në të shkuarën e vendit të tij qysh prej Gjergj Kastriotit e këndej.

³ Sh. Sinani, *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, Naimi, Tiranë, 2008, f. 27.

⁴ P. Kola, *Lirikat fetare të atë Fishtës*, revista Jeta e re-revistë letrare, nr. 3, Prishtinë 1996, f. 464.

⁵ A. N.Berisha, *Vepër e qenies dhe e qenësinë sonë (Vëzhgime mbi artin poetic të Fishtës)*, Shpresa & Faik Konica, Prishtinë, 2003, f. 271-272.

⁶ E. Sedaj, *Gjergj Fishta dhe vepra letrare e tij*, Hylli i Dritës, Tiranë, 1996, f. 63.

Romantizmi shqiptar, si dukuri letrare, lindi si hyjnizim me shikim prapa, por Fishta e solli më afër kohës së tij shikimin. Shpërngulja e problematikës së letërsisë prej periudhës legjendare në atë historike do të mbetet një prej vlerave të rëndësishme të veprës së tij⁷.

«Lahuta» asht epopea shqiptare, është kënga e naltësimit të burrnís arbnore, është hymni i virtytevet të banorvet të malevet kreshnike është çfaqja e vendosmënis së popullit për të mos i lëshue asnjë pëllambë tokë Slavít të mënijshëm, që gjithmonë i ká ndëjë si orrl Shqipnís mbí krye për ta përpí. Në krejt veprën fishtjane del në shesh dashuniya për vendin e të Parëvt⁸, shprehej Karl Gurakuqi në një artikull në revistën Shejzat “Pse kaq meni kundër Fishtës.

Vepra e tij letrare, me pasurinë zhanrore dhe stilistikore që e karakterizon, dëshmon aftësinë dhe imagjinatën krijuese të autorit në njërën anë dhe, në anën tjetër njohjen e tij të thellë dhe të gjithanshme të krijimtarisë letrare gojore dhe të shkruar shqiptare si dhe të letërsive të shkruara të popujve të tjerë të Ballkanit e të Evropës.

Fishta lindi dhe u rrit në një mjedis ku epika gojore, por edhe llojet e tjera të poezisë sonë gojore, bënë një jetë intensive në shtresat e ndryshme të popullsisë, gëzonin prestigj dhe përjetoheshin si një art i madh.

Duke i qenë i bindur për vlerat e artit popullor, por edhe i vetëdijshëm se pjesa më e madhe e bashkëkohësve të tij nuk dinin shkrim dhe lexim, Fishta e shkroi veprën e vet duke u mbështetur gjerësisht në poezinë gojore: në sistemin figurativ shprehës folklorik, në modelet formulative të retorikës tradicionale, në kumtin e drejtpërdrejtë emocional që del nga vargjet e tyre.

Për krijimin e veprës së vet ai zgjodhi vargun tetërrokësh, me të cilin u krijuan pjesa më e madhe e llojeve të lirikës gojore si dhe këngët me tematikë historike, që ishin mjaft të përhapura në kohën e Fishtës.

⁷ Sh. Sinani, *Sipërrore*, botimet Extra, Tiranë, 1998, f. 21-22.

⁸ Shih: K.Gurakuqi, *Pse kaq mëní kundra Fishtës?*, revista “Shêjzat”, Romë, 1961, f. 411.

Poet kombëtar qëkur ishte gjallë, në vitet 30-të të shek. të kaluar, poet i studiuar intensivisht edhe në çerekshkullin e fundit, megjithatë Fishta, universi i tij letrar ka mjaft për të zbuluar e shfaqur.

Tradita shihet si burim historik për ndërtimin e së tashmes. Tradita dhe historia, në mënyra të ndryshme i japin tone dhe ngjyime të larmishme rrëfimit.

Kur tradita dhe historia janë trajtuar si të lidhura afër, kanë zënë pozicione të ngjashme përballë modernitetit. Në diskurset e trashëgimisë ato i japin funksion pozitiv shërbimit të modernes; prania e paraqitjeve të tyre sugjeron vazhdimësinë kulturore pranë kuptimit të përgjithshëm të thyerjes.

Tradita si histori mund të nënkuptojë dy gjëra reciprokisht të kundërta. Në plotësim të së kaluarës si e kaluar historike, tradita dhe tradicionalja mund t'i referohen të kaluarës në të tashmen, vazhdimësisë së të kaluarës në modele dhe gjedhe të së folurës, mendimeve, besimeve, praktikave kulturore.

Këtu luan rol vendimtar elementi traditë-autor-lexues, teksti gojor na vjen nëpërmjet traditës gojore.

Përmes këtyre dy aspekteve me të cilat mund të arrihet të sqarohet dinamika e krijimit të tekstit gojor, e cila njëra është diakronike dhe tjetra sinkronike. Në këtë dinamikë linin dhe përpunohen në rrjedhë të kohës dhe krijimet folklorike.

Tekstet folklorike janë vazhdimisht në lëvizje, ato lindin dhe zhduken për të rilindur përsëri në një formë më të ndryshuar⁹.

Në këtë mënyrë letërsia gojore kthehet në një konstante përcaktuese për fatin e letërsisë së kultivuar autoriale, nga ngjizja te kurorëzimi përfundimtar në shoqërinë bashkëkohëse.

Krijimi letrar gojor lind si shprehje e vetëdijes, e përvojës dhe e shijes së traditës të caktuar, por njëherësh edhe e vetëdijes, e përvojës dhe e shijes se lexuesve që kanë.

Vepra letrare gojore më ngushtë është e lidhur me grupin e apo me traditën e caktuar se sa krijimet e tjera të artit të fjalës.

⁹ Folkloristikë, koncepte moderne, Dukagjini, Pejë, 2006, f. 60-61.

Secili krijues gojor ka parasysh traditën, qarkun kulturor, apo rrethin e lexuesve që e rrethon, prandaj me plot të drejtë veprën e vet ia përshtat asaj vetëdije, sepse: “*Secili grup posedon vetëdijen e përbashkët, ndërsa çdo vetëdije e përbashkët ka në vete poezinë e vet, artin e vet, sikur që ka edhe të folurit e vet. Secili popull-prapë si bashkësi ka poezinë e vet*”¹⁰.

Moderniteti i letërsisë së çdo vendi ka përkuar me kulmin e pjekurisë krijuese- kritike si individualizëm i skajshëm autorial dhe si vetëdije e lartë qytetare, njëkohësisht, çka e vërteton mes të tjerash dhe shkatërrimi i miteve tradicionale-folklorike (destruktivizmin e tyre), kristalizimi i kultit autorial, në disarmoni dhe konfliktualitet me mjedisin dhe rendin e ngrirë hierarkik të vlerave dhe idhujve të trashëguar nga e kaluara.

Letërsia gojore, para së gjithash, mbulon fushën e gjerë të tregimeve, legjendave, rrëfimeve folklorike, që kalojnë gojarisht nga brezi në brez, të cilat nuk zhduken, por përfundojnë si tekste të shkruara. Një nga vështirësitë kryesore të letërsisë gojore është kthimi i saj në tekst të shkruar¹¹.

Kalimi i letërsisë gojore në letërsi të shkruar lindi si nevojë që nga fillimet e zbulimit të shkrimit, përkatësisht të krijimit të veprave të letërsisë së shkruar dhe u shtri në periudha të ndryshme dhe në letërsitë e shumë popujve, për të mbërritur edhe në ditët tona.

Fishta e ndoqi dhe e thelloi këtë traditë të pasur në letërsinë tonë, duke i dhënë atë dimension e thellësi që nuk e kishte pasur deri atëherë. Këtë e bëri sidomos me veprën “*Lahuta e Malcís*”¹².

Nga kontaktet me popullin, ia vë veshin ligjëritimit popullor, frazeologjizmave dhe fjalëve të urta. Ai do ta studiojë edhe mentalitetin e popullit, urtësinë, këngët, legjendat, gjithë atë thesar zanash, orësh, që më vonë do t’i mishërojë me mjeshtri të rallë dijtë t’i gërshetojë në veprat e veta, e sidomos në kryeveprën “*Lahuta e Malcisë*”¹³.

¹⁰ A. N. Berisha, *Çështje të letërsisë gojore*, Rilindja, Prishtinë, 1982, f. 32.

¹¹ Y. Chevrel, *Letërsia e krahasuar*, PUF, Tiranë, 1997, f. 98.

Për Fishtën dhe veprimtarinë e tij shih dy vëllimet, *At Gjergj Fishta*, Shkëndija, 1941; *At Gjergj Fishta (1871-1940)*, Botim Distriptur, Tiranë 1944.

¹³ Po aty, 134.

Malësoni në Lahutë njihte veten, këndonte trimëritë e veta e të parëve, tregonte luftërat dhe njihte fitoret, nderin, besën e fjalën, kanunin doketar.

Marrëdhënia e fuqishme e veprës së Fishtës me folklorin, ka një ndikim pozitiv, si për nga karakterizimi psikologjik i situatave, ashtu dhe nga natyrshmëria e komunikimit me receptuesin hipotetik.

Një veçori e letërsisë gojore është roli psikologjik dhe funksional i saj. Në strukturën e krijimeve letrare gojore, si elemente kryesore konsiderohen edhe formulësimet. Kështu studiuesi i njohur i çështjeve dhe i problemeve homerike, *Milan Parry*, formulësimet në poezinë gojore do t'i emërtojë si "*grumbull fjalësh*" që rregullisht përdoren në kushte të njëjta metrike për të shprehur një ide qenësore të caktuar¹⁴.

Formulësimet që janë të shumta në poemë, kalojnë përmes të qenit brenda asaj që e kemi quajtur letërsi gojore, flasim duke ju referuar temave të *Albert Lordit* oralitetit gojor, ku këto formulësimet marrin detyrimisht edhe një vlerë antropologjike dhe folklorike.

Krijimtaria shpirtërore në përgjithësi, po edhe letërsia gojore në veçanti është studiuar kryesisht nga aspekti i elementeve tematike-motivore, formësore, si dhe i ndikimit të saj estetik në marrësin.

Me kohë shtohen edhe studimet e kësaj letërsie në raport me traditën, me format, llojet e stilin e saj, që njëkohësisht janë edhe karakteristikat e saj dalluese nga letërsia e shkruar¹⁵.

Bashkësia apo rrethi shoqëror ku lind një krijim gojor popullor e pranon atë, atëherë ky krijim, prej çastit të përvetësimit nga ana e mjedisit të caktuar do ta fitojë edhe legjitimitetin e vet folklorik. Kjo sa e dëshmon karakterin individual të letërsisë gojore, aq kësaj i jep dimensione edhe të karakterit kolektiv.

Mirëpo, te një shtresë tjetër shoqërore, te një numër individësh e grupesh, as epika e as lirika nuk mund të mbërrinin qëllimin që synonte dhe dëshironte Fishta. Për këtë arsye ai krijoi poezinë satirike. Kjo poezi i kushtohet asaj shtrese që ishte zhveshur nga

¹⁴ A. Lord, *The singer of Tales*, Harvard University Press, Cambridge, Massachusetts London, England, 2000, f. 3-4.

¹⁵ L.Gega-Musa, *Refleksione folkloristike*, IAP, Prishtinë, 2011, f. 39.

Gjergj Fishta, një vetëdije estetiko-atdhetare, dy tablo kontrastuese nga atdheu

virtyte dhe tipare kombëtare; disa individë ishin bërë vegla të sunduesit ose të aparatit shtetëror, duke u dhënë kështu pas pasurimit dhe interesave vetjake. Fishta ishte i bindur se te kjo shtesë poezia e tillë do të ndikonte që ata t'i ktheheshin sado pak vetvetes dhe interesave të kombit e të atdheut, që po kanoseshin nga anë e nga nivele të ndryshme¹⁶.

Fishta është poet i madh i letërsisë shqipe edhe si satirik. Kjo dëshmohet me dy veprat e tij *“Anzat e Parrnasit”* dhe *“Gomari i Babatasit”*, të cilat janë ngritur mbi bazën e humorit dhe satirës sonë gojore. Nëpërmjet gjuhës që e ndeshim në poezinë dhe në prozën tonë gojore humoristike, ai krijoi disa nga pjesët antologjike të poezisë së shkruar satirike shqiptare, jo vetëm për kohën kur krijoi e veprimi¹⁷, por edhe sot në ditët tona.

Rrafshi i leximeve të Fishtës është ndërtuar mbi katër burime kryesore:

1. Mbi burimin mitologjik,
2. Mbi burimin klasik,
3. Mbi burimin biblik,
4. Mbi burimin modern¹⁸.

Të gjitha këto burime kryesore kanë ndikuar në ndërtimin e satirës fishtiane. Në ndërtimin e satirës Fishta ka përdorur shumë fjalë turqizma që tregojnë mentalitetin, situatat, karakteret orientale të personazheve të veta. Këto turqizma luajnë rol të rëndësishëm në ndërtimin emocional në ndërtimin e satirës si fjalët: *adalet*, *fistan*, *lazem*, *nafakë*, *sebet*.

E gjithashtu n'epikën e Lahutës Fishta, tue u ba interpret i ndjenjës së popullit duhet të flijojë dashtë e pa dashtë turrin e vet vehtjak, atëherë atij i mbetshin çelë: dramatika e satirika. Por Fishta nuk punon dramatikën, tue e kufizue nder subjekte shpesh dore të dytë. E mandej ma mirë gjithmonë i përshtatej satira temperamentit

¹⁶ A. N. Berisha, *Veçanti ligjërimesh poetike*, Eurorilindja, Tiranë, 1996, f. 33.

¹⁷ Po aty, f. 27.

¹⁸ S. Çapaliku, *Poetika e satirës fishtiane*, në: *“Hylli i Dritës”*, nr. i posaçëm, Tiranë, 1996, f. 132.

të tij luftar. Ktu fitojmë ide ma të kjartë mbi karakterin e Fishtës theksonte Arshi Pipa¹⁹.

Gomari i Babatasit, është një vëllim satirik-humoristik, i botuar me pseudonimin Gegë Toska, në kohën kur Fishta qe anëtar i parlamentit shqiptar²⁰, nga ku përqesh demagogjinë dhe falsitetin e shoqërisë së kohës, duke përfshirë edhe patriotizmin demagogjik²¹.

Te pjesa e parë, Gomari, jepet gjendja e vendit para hapjes së parlamentit, me ethet elektorale; ndërsa pjesa e dytë zhvillohet në sallën e parlamentit, ku debatojnë dy grupe personazhesh: klika e klikarët, përfaqësuar nga Kryeministri, Kryetari i parlamentit, dallkaukët e tyre, dhe grupi i dytë: Bosku, Tosku, Taravoli, Hundleshi.

Ju rrugaça e sallahâna,
Vagabonda shakllabana,
Rriqna t'ndyet, mikrobë të kqì,
Qi të mjerres moj Shqypni
Pa dhimë gjakun tuj pa pì,
Po dër kuer, bre batakcì,
Bre coftina, kalbë mbì dhè!
Dër kuer ju, t' u tallë nper nè,
Do t' na qelbni fis e atdhe?
Ah! Bre jue.. nuk dië shka, u kjoftë,
Se tash mâ jemi tue u njoftë,
Se kush jini e se shka jini,
Se kahë shkoni e se kahë vîni,
Plang e shì se kahë i kini
E sa pare u ban jue gjaku:
Se per jue, po duhet laku,
Per me u vjerrë-o kund m'ndoj shpat!
Deri dje, pa kmishë mbì shtat,
Me 'i gjymsë setre t'pa astàr,
Lshuemun krahve kalavàr²².

¹⁹ A. Pipa, *Kritika esse 1940-1944*, Princi, Tiranë, 2006, f. 102-103.

²⁰ R. Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Pejë, 2001, f. 301.

²¹ Sh. Sinani, *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të*, Naimi, Tiranë, 2008, f. 29.

²² Gj. Fishta, *Gomari i Babatasit*, Tiranë, 1923, f. 67-68. (Babatasi).

Kjo ndikoi që Fishta të ketë parasysh marrësin dhe mundësinë e ndikimit sa më të madh të veprës së tij në të, gjë që, para së gjithash, lidhej me kushtet dhe me kontekstin e kohës.

Duke lexuar veprën e tij epike dhe disa poezi satirike mund të themi me bindje se Fishta është një poet i ngritur mbi frymën kombëtare të artit të fjalës.

Përkimet poetike dhe ndikimet e krijimtarisë gojore në krijimtarinë e Fishtës vërehen edhe në llojet e tjera të veprimtarisë së tij: në poezinë lirike, satirike, në dramatikë dhe në prozë²³.

Situatat paradoksale dhe satira e tij drejtohet kundër tradhtarëve, atdhemohuesve, parazitëve.

Krahas epikës, Fishta, ndoshta edhe më lart qëndron në fushën e satirës. Aty do t'i gjejmë tonet më të theksuara therëse, tallëse e sarkastike.

Se Shqypnija, fushë e male,
Asht bâ sod “akçidentale”....
Deshta t’tham “okçidentale”²⁴.

Fishta s’ka ironi të butë apo tallje dinake, ai lëshon rrufe e shigjeta, qortimi i tij merr trajtën e një kamxhiku dhe bëhet sarkastik, që është karakteristikë e njeriut moralisht të pastër, sic ishte ky poet luftëtar i devotshëm. Arti poetik dhe sensibiliteti ritmik spikasin në shkallën më të lartë pikërisht në poezinë satirike. Fishta nuk i duroi dot në asnjë mënyrë hipokritët dhe të metat shoqërore e politike, që kishin filluar të lëshojnë rrënjë atë botë në mjediset shqiptare²⁵.

Mbi ’i gomar një kangë me shkruë,
Herë tue qeshë, herë tue vajtue,
Si mbas rregullave t’Poezisë,
E nevojave t’Shqyptaris²⁶.

Poezinë e vet satirike, sikur ndodh dhe me atë epike, Fishta e ndërton nëpërmjet gjuhës që përdoret në poezinë humoristike dhe

²³ A. N. Berisha, *Vepër e qenies*, vep. e cit., f. 298.

²⁴ Gj. Fishta, *Gomari i Babatasit*, Tiranë, 1923, f. 25.

²⁵ H. Xhaferi, *Figura emblematike të shqiptarizmit (autorë dhe vepra)*, Çabej, Tetovë, 2000, f. 137.

²⁶ Gj. Fishta, *Gomari i Babatasit*, Tiranë, 1923, f. 8-9.

satirike, por edhe në llojet e tjera të krijimtarisë gojore. Një përcaktim i këtillë i autorit nuk ka qenë i rastit²⁷.

Kta, po, janë antikomtarë, / Njerz t'rrezikshem fanatikë, / Marrë gjithmonë me politikë²⁸.

Në poezinë e tij satirike Fishta trajtoi disa tema aktuale dhe ngjarje që lidheshin me veset e me të metat e individëve, duke filluar nga ata të pushtetit e deri tek ata të zakonshmit; kritikonte e thumbonte aparatin shtetëror dhe të gjithë ata që lidheshin me të. Në mënyrë të veçantë kritikoi pseudopatriotët dhe njerëzit e tillë, që ishin në gjendje, siç thotë Fishta, ta shesin atdheut për një grosh!²⁹.

Babatas, mjaft punë e keqe
Per një shtet "okcidental",
Si ky i joni, as n'fushë as n'mal
Mos me pasun një Muzë;
Jo, po është turp, besa per në³⁰.

Kritikoi, pa i kursyer, të gjithë ata që e konsideronin veten njerëz që lexojnë shumë dhe janë të dijshtëm, ndërsa në qenësi ishin pseudointelektualë. Thumboi demagogjinë dhe demagogët, nga cilado shtesë qofshin. Nuk i kurseu sidomos individët që kishin sjellje të papërgjegjësi në kohën kur nevoja për forcimin e vetëdijes nacionale dhe ekzistencën nacionale duhej të ishte në krye të të gjitha synimeve dhe detyrave. Krahas kësaj ai trajtoi tema që lidheshin me korrupsionin, me pasurinë dhe të metat e tjera të shoqërisë shqiptare të kohës³¹.

Nuk di gjâ, por me gjith kta,
Me gjithse edhe t'pa zotsi,
Na po i shofim ke n' Shqypni
Qëni t'zo'n mâ s'po e njëh,
E pedanta e Don kishjote,
Me një hije krejt kokote,
Tuj u mbajtë per liberala,

²⁷ A. N. Berisha, *Vepër e qenies*, vep. e cit., f. 299.

²⁸ Gj. Fishta, *Gomari i Babatasit*, Tiranë, 1923, f. 15.

²⁹ A. N. Berisha, *Vepër e qenies*, vep. e cit., f. 300.

³⁰ Gj. Fishta, *Gomari i Babatasit*, Tiranë, 1923, f. 21.

³¹ A. N. Berisha, *Vepër e qenies*, vep. e cit., f. 300.

Per modern e okcidentala,
Sidomos n'kto kohët e mbrame
Pjellin ligjë, vjellin programe,
Apin urdhna edhe dekreta,
Sjellin gjinden poshtë-perpjeta,
E n'ket mndyrë ç'do perparim
Kan pengue, e mbrendë n'sundim
Njerz e pûnë kaq kan pshtjellue,
Kaq perzie e kaq ngatrrue³².

Në veprën e tij të njohur satirike, “Gomari i Babatasit”, Fishta sulmon ashpër pseudopatriotët, përfaqësuesit e shtetit, nëpunësit shtetërorë dhe njerëzit e tjerë përgjegjës për mirëvajtjen dhe zhvillimin e jetës shqiptare, të cilët nuk interesoheshin për atdheut dhe për kombin, por ishin dhënë pas kënaqësive dhe fitimeve vetjake³³.

Me gjith kta, populli i ngratë
Prap kà ngelun me bukë thatë,
E me crule e zhele m'shtat,
E me krye aj per nen bat,
Tuj u vrà kta dikuer motit³⁴.

Vepra është një ballafaqim satirik i patriotizmit opozitar dhe i demagogjisë së pushtetarëve në parlamentin e kohës. Ajo pulson një polemikë therëse, sepse e ngacmoi demagogjia e pseudopatriotëve, e nxiti ashtuqejtuni laicizim i shkollës, e thumboi antiklerikalizmi e desh i mori frymën bizantizmi orriental e fryma anadollake³⁵.

Kà Ministra bataçqi,
Njerz kopukë t'pa farë kulture,
Zêmren lepur, mendt kubure,
Thonin krrabë e kryet matare.
Edhë kta po, lum kumara,
Per xhep t'vet një herë mâ para,

³² Gj. Fishta, *Gomari i Babatasit*, Tiranë, 1923, f. 33.

³³ A. Nikë Berisha, *Vepër e qenies*, vep. e cit., f. 302.

³⁴ Gj. Fishta, *Gomari i Babatasit*, vep. e cit., Tiranë, 1923, f. 47. (Drejtori B).

³⁵ S. Çapaliku, *Poetika e satirës fishtiane*, në: “Hylli i Dritës”, nr. i posaçëm, Tiranë, 1996, f. 137.

masandej, n'teproftë ndojsend,
per atdhe: thue se njimend
trashigim Shtetin kan pasë
me gjith tokë, e landë e rrasë³⁶.

Në satirë Fishta i ka vënë vetes qëllim të paraqesë atë dukuri e cila nuk mund të paraqitet veçse ashtu siç është: si deformim, si tjetërsim i personalitetit njerëzor. Së pari, personazhet satirikë, që mishërojnë një dukuri shoqërore, nuk evoluojnë. Ata i ndesh e i rindesh gjithmonë identikë me vetveten, kurrë një ngjarje nuk u shkakton shndërrime vendimtare në mënyrën e të menduarit a të të ndierit, rruga e tyre është e rrafshët, të papritura nuk ka.

Personazhet satirikë të Fishtës mbajnë emra realë, por edhe emra simbolikë, në të cilët lexohet lehtë stereotipi i karaktereve të tyre. Personazhet e dialogut satirik mund të quhen Ndrekë e Gasper (Gjuha e mësimi), ashtu sikurse mund të quhen Ndrekë e Prend (Nevoja e mësimi).

Kjo mënyrë e artit të Fishtës për të konceptuar e përshkruar personazhin i përket letërsisë moderne, e cila parapëlqen t'i organizojë lexuesit një takim brutal, të drejtpërdrejtë e të pandërmjetuar me një personazh të identifikueshëm në vend, thuajse pa shëmbëlltyrë fizike³⁷.

Gjergj Fishta do të mbetet për më se një shekull personaliteti më i spikatur i kulturës letrare shqipe, duke u çmuar si klasiku më i dalluar i kësaj letërsie. Ai ndërtoi një univers letrar, një Olimp Shqiptar, me qenie mitike e reale, duke ndërtuar kontraste të fuqishme dhe dramatike të letërsisë; madje më dramatikët në letërsinë shqipe. Aty ndeshim diskursin më glorifikues, por edhe diskursin më sarkastik, që bëhen përmes ironisë së hollë, ku autori godet pamëshirë pseudoatdhetarin. Përmes veprës së vet të larmishme, autori donte të theksonte një aspekt të rëndësishëm për shqiptarët; një identiteti kolektiv, që endet si karakteristikë e përhershme e veprës së tij.

³⁶ Gj. Fishta, *Gomari i Babatasit*, Tiranë, 1923, f. 82-83.

³⁷ A. Plasari, *Moderniteti i një satire klasike*, në: "Hylli i Dritës", nr i posacëm, Tiranë, 1996, f. 160-161.